



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**V E N D I M**

**Nr. 495, Datë 08.02.2018**

**“Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” SHA për mos përmbushjen e detyrimit të vendosur nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin Nr. 475, datë 21.09.2017”**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 74 dhe nenin 75 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe Rregulloren “Për Gjobat dhe Lehtësimin prej Tyre”,

**VENDOSI:**

1. Konstatimin e mos përmbushjes së detyrimeve të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 475, datë 21.09.2017 nga ndërmarrjet “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” SHA;
2. Gjorbitjen e ndërmarrjeve “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” SHA për shkelje të rëndë të konkurrencës, konkretisht të nenit 74, të Ligjit Nr. 9121/2003 në masën 0.02 % të xhiros së secilës ndërmarrjeje për vitin paraardhës financiar, përkatësisht në shumën 3 011 173 (tre milion e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) Lekë për ndërmarrjen “Vodafone Albania” SHA dhe në shumë 1 779 108 (një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetë) Lekë për ndërmarrjen “Telekom Albania” SHA;
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**